

# STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 810 (I RISHIKUAR)

## ANGAZHIMET PËR RAPORTIMIN MBI PASQYRAT FINANCIARE TË PËRMBLEDHURA

(Ka hyrë në fuqinë angazhimet për raportimin mbi pasqyrat financiare të përmbledhura për periudhat që përfundojnë në datën 15 dhjetor 2016 ose pas kësaj date)

### PËRMBAJTJET

|  | Paragrafi |
|--|-----------|
| <b>Hyrje</b>   |           |
| Objekti i këtij SNA-je.....  | 1         |
| Data e Hyrjes në Fuqi.....   | 2         |
| Objektivat .....   | 3         |
| Përkufizimet .....   | 4         |
| <b>Kërkesat</b>  |           |
| Pranimi i Angazhimit .....   | 5–7       |
| Natyra e Procedurave .....   | 8         |
| Formimi i Opinionit.....   | 9–11      |
| Afatet e e Punës dhe Ngjarjet pas Datës së Raportimit të Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Audituar..... | 12–13     |
| Informacione në Dokumentet që Përbajnë Pasqyra Financiare të Përmbledhura .....                              | 14–15     |
| Raporti i Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura .....   | 16–21     |
| Kufizimi i Shpërndarjes ose Përdorimit ose Njoftimi i Lexuesit për Bazën Kontabël .....                      | 22        |
| Të Dhënat Krahasuese.....  | 23–24     |
| Informacione Plotësuese të Paaudituar të Paraqitura së bashku me Pasqyrat Financiare të Përmbledhura.....    | 25        |
| Lidhja e Audituesit .....  | 26–27     |
| <b>Aplikimi dhe Materiali Tjetër Shpjegues</b>   |           |

|   |         |
|---|---------|
| Pranimi i Angazhimit .....  | A1–A7   |
| Vlerësimi i Disponibilitetit të Pasqyrave Financiare të Audituar.....                                     | A8      |
| Forma e Opinionit.....  | A9      |
| Afatet e Punës dhe Ngjarjet pas Datës së Raportit të Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Audituar ..... | A10     |
| Informacione në Dokumentet që Përmbajnë Pasqyra Financiare të Përmbledhura .....                          | A11–A16 |
| Raporti i Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura .....  | A17–A23 |
| Të Dhënat Krahasuese.....   | A24–A25 |
| Informacione Plotësuese të Paaudituar të Paraqitura së bashku me Pasqyrat Financiare të Përmbledhura..... | A26     |
| Lidhja e Audituesit .....   | A27     |
| Shtojcë: Ilustrime të Raportëve të Audituesve të Pavarur mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura          |         |

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 810 (i Rishikuar), *Angazhimet për Raportimin mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura*, duhet të lexohet së bashku me SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*.

## Hyrje

### Objekti i këtij SNA

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësitë e audituesit në lidhje me një angazhim për raportimin mbi pasqyrat financiare të përmbledhura që rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara në përputhje me SNA-të nga i njëjti auditues.

### Data e Hyrjes në Fuqi

2. Ky SNA hyn në fuqi për angazhimet për raportimin mbi pasqyrat financiare të përmbledhura për periudhat që përfundojnë me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date.

## Objektivat

3. Objektivat e audituesit janë:
  - (a) Të përcaktojë nëse është e përshtatshme të pranohet angazhimi për raportimin mbi pasqyrat financiare të përmbledhura; dhe
  - (b) Nëse angazhohet për të raportuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura:
    - (i) Të formojë një opinion mbi pasqyrat financiare të përmbledhura bazuar në një vlerësim të konkluzioneve të nxjerra nga evidenca e siguruar; dhe
    - (ii) Të shprehë qartë këtë opinion nëpërmjet një raporti me shkrim, që përshkuan gjithashtu, bazën për këtë opinion.

## Përkufizimet

4. Për qëllimet e këtij SNA-je, termat e mëposhtem kanë kuptimet që vijojnë:
  - (a) Kriter i aplikuar – Kriteri i aplikuar nga drejtimi për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura.
  - (b) Pasqyrat financiare të audituara – Pasqyrat financiare<sup>1</sup> të audituara nga audituesi në përputhje me SNA-të, nga të cilat rrjedhin pasqyrat financiare të përmbledhura.
  - (c) Pasqyrat financiare të përmbledhura – Informacion financiar historik që rrjedh nga pasqyrat financiare por që përmban më pak detaje sesa pasqyrat financiare, ndonëse ende jep një paraqitje të strukturuar në

<sup>1</sup> SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 13(f), përkufizon termin “pasqyra financiare”.

përputhje me atë të dhënë nga pasqyrat financiare të burimeve ose detyrimeve ekonomike të entitetit në një datë të dhënë ose ndryshimeve në këto burime për një periudhë kohe.<sup>2</sup> Për të përshkruar një informacion të tillë financiar historik, juridiksione të ndryshme mund të përdorin terminologji të ndryshme.

## Kërkesat

### Pranimi i angazhimit

5. Audituesi do të pranojë një angazhim për të raportuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura në përputhje me këtë SNA vetëm atëhere kur audituesi ka qenë angazhuar për të kryer një auditim, në përputhje me SNA-të, të pasqyrave financiare nga të cilat rrjedhin pasqyrat financiare të përmbledhura. (Ref: Para. A1)
6. Perpara se të pranojë një angazhim për të raportuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, audituesi do të: (Ref: Para. A2)
  - (a) Përcaktojë nëse kriteret e aplikuara janë të përshtatshme; (Ref: Para. A3–A7)
  - (b) Sigurojë marrëveshjen me drejtimin e cila tregon se ky i fundit, e pranon dhe kupton përgjegjësinë e tij:
    - (i) Për të përgatitur pasqyrat financiare të përmbledhura në përputhje me kriteret e aplikuara;
    - (ii) Për t'i vënë pasqyrat financiare të audituara në dispozicion të përdoruesve të synuar të pasqyrave financiare të përmbledhura, duke shmangur pengesat e panevojshme (ose, nëse ligji ose rregulloret përcaktojnë se pasqyrat financiare të audituara nuk duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve të synuar të pasqyrave financiare të përmbledhura, dhe përcakton kriteret për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura, drejtimi do të përshkruajë këtë ligj ose rregull në pasqyrat financiare të përmbledhura.); dhe
    - (iii) Për të përfshirë raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura në cilindo dokument që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe që tregon se audituesi ka raportuar mbi ato.
  - (c) Të bjerë dakord me drejtimin mbi formën e opinionit që do të shprehet mbi pasqyrat financiare të përmbledhura (shih paragrafet 9–11).
7. Nëse audituesi arrin në përfundimin se kriteret e aplikuara janë të

<sup>2</sup> SNA 200, paragrafi 13(f)

papranueshme ose ai nuk arrin marrëveshjen me drejtimin, siç përcaktohet në paragrafin 6(b), audituesi nuk do të pranojë angazhimin për të raportuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, përveç nëse kjo kërkohet nga ligji ose rregullat. Një angazhim i kryer në përputhje me një ligj ose rregull të tillë, nuk është në pajtim me këtë SNA. Për rrejdhojë, raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura nuk do të tregojë se angazhimi është kryer në përputhje me këtë SNA. Audituesi do të përfshijë një referencë të përshtatshme ndaj këtij fakti në kushtet e angazhimit. Audituesi do të përcaktojë gjithashtu efektin që mund të ketë ky fakt mbi angazhimin për të audituar pasqyrat financiare nga të cilat rrjedhin pasqyrat financiare të përmbledhura.

### Natyra e procedurave

8. Audituesi do të ndjekë procedurat e mëposhtme, si dhe çfarëdoj procedure tjetër që ai konsideron të nevojshme si bazë për opinionin e tij mbi pasqyrat financiare të përmbledhura:
  - (a) Të vlerësojë nëse pasqyrat financiare të përmbledhura shprehin në mënyrë të përshtatshme natyrën e tyre të përmbledhur dhe identifikojnë pasqyrat financiare të audituara.
  - (b) Kur pasqyrat financiare të përmbledhura nuk janë të shoqëruara nga pasqyrat financiare të audituara, të vlerësojë nëse ato përshkruajnë në mënyrë të qartë:
    - (i) Nga kush ose ku vihen në dispozicion pasqyrat financiare të audituara; ose
    - (ii) Ligjin ose rregulloren që specifikon se nuk është e nevojshme që pasqyrat financiare të audituara të vihen në dispozicion të përdoruesve të synuar të pasqyrave financiare të përmbledhura, dhe që përcakton kriteret për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura.
  - (c) Të vlerësojë nëse pasqyrat financiare të përmbledhura informojnë në mënyrë të qartë mbi kriteret e aplikuara.
  - (d) Të krahasojë pasqyrat financiare të përmbledhura me informacionin përkatës në pasqyrat financiare të audituara, për të përcaktuar nëse pasqyrat financiare të përmbledhura përputhen me, apo mund të rrillogariten nisur nga informacioni përkatës në pasqyrat financiare të audituara.
  - (e) Të vlerësojë nëse pasqyrat financiare të përmbledhura janë përgatitur në përputhje me kriteret e aplikuara.
  - (f) Të vlerësojë, duke marrë parasysh qëllimin e pasqyrave financiare të përmbledhura, nëse këto të fundit përmbajnë informacionin e nevojshëm,

dhe janë në një nivel të përshtatshëm bashkimi, me qëllim që të mos çorientojnë për rrethanat.

- (g) Të vlerësojë nëse pasqyrat financiare të audituara janë në dispozicion të përdoruesve të synuar të pasqyrave financiare të përmbledhura, pa vështirësi të panevojshme, përveç nëse ligji ose rregullat përcaktojnë se nuk është e nevojshme që ato të vihen në dispozicion dhe përcaktojnë kriteret për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura. (Ref: Para. A8)

### Forma e Opinionit

9. Kur audituesi ka arritur në përfundimin se mbi pasqyrat financiare të përmbledhura do të jepet një opinion i pamodifikuar, opinion i audituesit, përveç nëse kërkohet ndryshe nga ligji ose rregullat, do të përdorë një nga frazat e mëposhtme: (Ref: Para. A9)
  - (a) Pasqyrat financiare të përmbledhura bashkëngjitur janë në koherencë, në të gjitha aspektet materiale, me pasqyrat financiare të audituara, sipas [*kritereve të aplikuara*]; ose
  - (b) Pasqyrat financiare të përmbledhura bashkëngjitur janë një përmbledhje e drejtë e pasqyrave financiare të audituara, në përputhje me [*kriteret e aplikuara*].
10. Nëse ligji ose rregullat përshkruajnë formulimin e opinionit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura me terma, që janë të ndryshme nga ato të përshkruara në paragrafin 9, audituesi do të:
  - (a) Aplikojë procedurat e përshkruara në paragrafin 8 si dhe çfarëdo procedure tjetër, të nevojshme, që i jep mundësi audituesit të shprehë opinionin e përshkruar; dhe
  - (b) Vlerësojë nëse përdoruesit e pasqyrave financiare të përmbledhura mund të keqkuptojnë opinionin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, dhe nëse po, të vlerësojë faktin nëse shpjegimet e mëtejshme në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, mund të zvogëlojnë keqkuptimet e mundshme.
11. Nëse, në rastin e paragrafit 10(b), audituesi arrin në konkluzionin që shpjegimet shitesë në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, nuk mund të zvogëlojnë keqkuptimet e mundshme, audituesi nuk do të pranojë angazhimin, përveç nëse kjo i kërkohet nga ligji ose rregullat. Një angazhim i kryer në përputhje me një ligj ose rregullorë të tillë nuk është në përputhje me këtë SNA. Për rrjedhojë, raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura nuk do të tregojë se angazhimi ka qënë kryer në përputhje me këtë SNA.

## **Afatet e Punës dhe Ngjarjet Pas Datës së Raportit të Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Audituarra**

12. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura mund të datohet më vonë se data e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të audituarra. Në raste të tilla, raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, do të deklarojë se pasqyrat financiare të përmbledhura dhe pasqyrat financiare të audituarra nuk pasqyrojnë efektet e ngjarjeve që kanë ndodhur pas datës së raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të audituarra. (Ref: Para. A10)
13. Audituesi mund të bëhet i vetëdijshëm për fakte që ekzistonin në datën e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të audituarra, por për të cilat audituesi nuk ishte në dijeni më parë. Në raste të tilla, audituesi nuk do të lëshojë raportin e tij mbi pasqyrat financiare të përmbledhura deri sa të ketë përfunduar vlerësimin e këtyre fakteve në lidhje me pasqyrat financiare të audituarra në përputhje me SNA 560<sup>3</sup>.

## **Informacione në Dokumentet që Përmbajnë Pasqyra Financiare të Përmbledhura**

14. Audituesi do të lexojë informacionin e përfshirë në një dokument që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raportin e audituesit mbi këto pasqyra dhe vlerëson nëse ka një mospërputhje materiale midis këtij informacioni dhe pasqyrave financiare të përmbledhura.
15. Nëse audituesi identifikon një mospërputhje materiale, ai do të diskutojë çështjen me drejtimin dhe të përcaktojë nëse duhet të rishikohen pasqyrat financiare të përmbledhura ose informacioni i përfshirë në dokumentin që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raportin e audituesit mbi to. Nëse audituesi vlerëson se informacioni duhet të rishikohet dhe drejtimi refuzon të rishikojë informacionin sipas nevojës, audituesi do të ndërmarrë veprimet e duhura për rrethanat, duke përfshirë vlerësimin e ndikimeve në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura. (Ref: Para. A11–A16)

## **Raporti i Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

### *Opinion i Modifikuar mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura*

21. Nëse pasqyrat financiare të përmbledhura nuk janë në koherencë, në të gjitha aspektet materiale, me pasqyrat financiare të audituarra ose nuk japin një përmbledhje të drejtë të këtyre të fundit, në përputhje me kriteret e aplikuarra, dhe drejtimi nuk pranon të bëjë ndryshimet e nevojshme, audituesi do të shprehë një opinion kundër mbi pasqyrat financiare të përmbledhura. (Ref: Para. A23)

### *Elementet e Raportit të Audituesit*

<sup>3</sup> SNA 560, *Ngjarjet e mëvonshme*

16. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura do të përfshijë elementët e mëposhtëm:<sup>4</sup> (Ref: Para. A23)
- (a) Një titull që shpreh qartë se bëhet fjalë për raportin e një audituesi të pavarur. (Ref: Para. A17)
  - (b) Një marrës. (Ref: Para. A18)
  - (c) Identifikimin e pasqyrave financiare të përmbledhura mbi të cilat audituesi po raporton, përfshirë titullin e secilës pasqyrë të përfshirë në pasqyrat financiare të përmbledhura. (Ref: Para. A19)
  - (d) Identifikimin e pasqyrave financiare të audituara.
  - (e) Sipas paragrafit 20, shprehjen e qartë të një opinionit (shih paragrafët 9-11).
  - (f) Një deklaratë që shpreh se pasqyrat financiare të përmbledhura nuk përmbajnë të gjitha informacionet e kërkuara nga kuadri i raportimit financiar të aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të audituara, dhe se leximi i pasqyrave financiare të përmbledhura dhe i raportit të audituesit mbi këto pasqyra, nuk mund të zëvendësojë leximin e pasqyrave financiare të audituara dhe raportin e audituesit mbi to.
  - (g) Kur është e zbatueshme, deklaratën e kërkuar nga paragrafi 12.
  - (h) Një referencë në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara, të datës së këtij raporti, dhe, sipas paragrafeve 19-20, të faktit që në pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion i pamodifikuar.
  - (i) Një përshkrim të përgjegjësisë së drejtimit<sup>5</sup> për pasqyrat financiare të përmbledhura, që shpjegon se drejtimi<sup>6</sup> është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura në përputhje me kriteret e aplikuar.
  - (j) Një deklaratë sipas së cilës, audituesi është përgjegjës për të shprehur një opinion, bazuar në procedurat e audituesit të kryera në përputhje me këtë SNA, për faktin nëse pasqyrat financiare të përmbledhura janë në të gjitha aspektet materiale, në koherencë [*ose japin një përmbledhje të drejtë të tyre*] me pasqyrat financiare të audituara.
  - (k) Firmën e audituesit.
  - (l) Adresën e audituesit.

<sup>4</sup> Paragrafët 19–20, të cilat trajtojnë rrethanat ku raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara ka qënë modifikuar, kërkojnë elementë shtesë ndaj atyre të listuara në këtë paragraf.

<sup>5</sup> Ose një term tjetër i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin përkatës.

<sup>6</sup> Ose një term tjetër i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin përkatës.



- (m) Datën e raportit të audituesit. (Ref: Para. A20)
17. Nëse marrësi i pasqyrave financiare të përmbledhura nuk është i njëjtë me marrësin e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara, audituesi do të vlerësojë nëse është e përshtatshme të përdoret një marrës tjetër. (Ref: Para. A18)
18. Audituesi do të datojë raportin e tij mbi pasqyrat financiare të përmbledhura jo më parë se: (Ref: Para. A20)
- (a) Data në të cilën audituesi ka siguruar evidencën e nevojshme (të mjaftueshme dhe të përshtatshme), mbi të cilën të bazojë opinionin, përfshirë evidencën që pasqyrat financiare të përmbledhura janë përgatitur dhe individët që kanë autoritetin, kanë pohuar se kanë marrë përgjegjësinë për këto pasqyra; dhe
- (b) Data e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara.

*Referenca në Raportin e Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Audituar* (Ref: Para. A23)

19. Kur raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përfshin:
- (a) Një opinion me rezervë në përputhje me SNA 705 (i rishikuar);<sup>7</sup>
- (b) Një paragraf që thekson një Çështje ose një paragraf për Çështje të tjera në përputhje me SNA 706 (i rishikuar);<sup>8</sup>
- (c) Një seksion të *Pasigurisë Materiale që Lidhet me vijimësinë*, në përputhje me SNA 570 (i rishikuar);<sup>9</sup>
- (d) Komunikimin e çështjeve kryesore të auditimit në përputhje me SNA 701;<sup>10</sup> ose
- (e) Një deklaratë që përshkruan një anomali materiale të pakorrigjuar në informacionin tjetër, në përputhje me SNA 720 (i rishikuar);<sup>11</sup>

dhe audituesi është i bindur se pasqyrat financiare të përmbledhura janë në koherencë, në të gjitha aspektet materiale, me pasqyrat financiare të audituara, ose ato japin një përmbledhje të drejtë të këtyre të fundit, në përputhje me kriteret e aplikuar, raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, përveç elementeve në paragrafin 16:

<sup>7</sup> SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

<sup>8</sup> SNA 706 (i rishikuar), *Paragrafët që theksojnë një çështje dhe paragrafet për çështje të tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur*

<sup>9</sup> SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*, paragrafi 22

<sup>10</sup> SNA 701, *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

<sup>11</sup> SNA 720 (i rishikuar), *Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Informacionet e Tjera*

- (i) Do të deklarojë se raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përfshin një opinion me rezervë, një paragraf që thekson një Çështje ose një paragraf për Çështje të Tjera, një seksion të *Pasigurisë Materiale që Lidhet me Vijmësinë*, komunikimin e çështjeve kryesore të auditimit, ose një deklaratë që përshkruan një anomali materiale të pakorrigjuar në informacionin tjetër; dhe (Ref: Para. A21)
  - (ii) Do të përshkruajë: (Ref: Para. A22)
    - a. Bazën për opinionin me rezervë mbi pasqyrat financiare të audituara dhe efektin e tyre, nëse ka, në pasqyrat financiare të përmbledhura;
    - b. Çështjen e përmendur në paragrafin që thekson çështjen ose në paragrafin për çështje të tjera, ose në seksionin e *Pasigurisë Materiale që lidhet me vijmësinë*, në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara dhe efektin(et) e tyre, nëse ka, në pasqyrat financiare të përmbledhura; ose
    - c. Anomalinë materiale të pakorrigjuar në informacionin tjetër dhe efektin (et) e saj/tyre, nëse ka, në informacionin e përfshirë në një dokument që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raportin e audituesit mbi to. (Ref: Para. A15)
20. Kur raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përmban një opinion kundër ose një refuzim të dhënies së opinionit, përveç elementëve në paragrafin 16, raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura do të:
- (a) Deklarojë që raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përmban një opinion kundër ose një refuzim të dhënies së opinionit;
  - (b) Përshkruajë bazën për këtë opinion kundër ose të refuzimit të dhënies së opinionit; dhe
  - (c) Deklarojë se, për shkak të opinionit kundër ose refuzimit të dhënies së opinionit mbi pasqyrat financiare të audituara, është e papërshtatshme shprehja e një opinionit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura. (Ref: Para. A23)

### **Kufizimi i Shpërndarjes ose Përdorimit, apo Njoftimi i Lexuesit mbi Bazën Kontabël**

22. Kur shpërndarja ose përdorimi i raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara është i kufizuar, ose raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara njofton lexuesit se pasqyrat financiare të audituara janë përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta, audituesi do të përfshijë një kufizim ose një njoftim të ngjashëm në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura.

## Të Dhënat Krahasuese

23. Nëse pasqyrat financiare të audituara përmbajnë të dhëna krahasuese, por pasqyrat financiare të përmbledhura nuk kanë të dhëna krahasuese, audituesi do të përcaktojë nëse kjo mungesë është e arsyeshme në rrethanat e angazhimit. Audituesi do të përcaktojë efektin e një mungese të paarsyeshme në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura. (Ref: Para. A24)
24. Nëse pasqyrat financiare të përmbledhura përmbajnë të dhëna krahasuese për të cilat ka raportuar një auditues tjetër, raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura do të përmbajë gjithashtu, çështjet që SNA 710 kërkon që audituesi të përfshijë në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara.<sup>12</sup> (Ref: Para. A25)

## Informacione Plotësuese të Paaudituar të Paraqitura së bashku me Pasqyrat Financiare të Përmbledhura

25. Audituesi do të vlerësojë nëse ndonjë informacion plotësues i paaudituar, i paraqitur së bashku me pasqyrat financiare të përmbledhura, është qartësisht i diferencuar nga pasqyrat financiare të përmbledhura. Nëse audituesi arrin në konkluzionin se paraqitja e informacionit shtesë të paaudituar të entitetit nuk është qartësisht i diferencuar nga pasqyrat financiare të përmbledhura, audituesi do t'i kërkojë drejtimin të ndryshojë paraqitjen e informacionit plotësues të paaudituar. Nëse drejtimi refuzon, audituesi do të shpjegojë në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura faktin që ky informacion nuk mbulohet nga raporti. (Ref: Para. A26)

## Lidhja e Audituesit

26. Nëse audituesi vihet në dijeni të faktit që entiteti planifikon që në një dokument që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura, të deklarojë se audituesi ka raportuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, por nuk planifikon të përfshijë raportin përkatës të audituesit, audituesi do t'i kërkojë drejtimin që të përfshijë raportin e audituesit në këtë dokument. Nëse drejtimi refuzon, audituesi do të përcaktojë dhe do të ndërmarrë veprime të tjera të përshtatshme me qëllim që të mos lejojë drejtimin të lidhë në mënyrë të papërshtatshme në atë dokument, audituesin me pasqyrat financiare të përmbledhura. (Ref: Para. A27)
27. Audituesi mund të angazhohet të raportojë mbi pasqyrat financiare të një entiteti, pa qënë i angazhuar për të raportuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura. Nëse, në këtë rast, audituesi vihet në dijeni të faktit që entiteti planifikon të bëjë një deklaratë në një dokument duke iu referuar audituesit

<sup>12</sup> SNA 710, *Informacionet Krahasuese—Shifrat korresponduese dhe Pasqyrat Financiare Krahasuese*

dhe faktit që pasqyrat financiare të përmbledhura rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara nga audituesi, ky i fundit duhet të sgurohet se:

- (a) Referenca ndaj audituesit bëhet në kontekstin e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara; dhe
- (b) Deklarata nuk krijon përshtypjen që audituesi ka raportuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura.

Nëse (a) ose (b) nuk përmbushen, audituesi do të kërkojë që drejtimi të ndryshojë deklaratën për të përmbushur (a) dhe (b), ose të mos i referohet audituesit në atë dokument. Ose në mënyrë alternative, entiteti mund të angazhojë audituesin për të raportuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura dhe të përfshijë raportin e audituesit përkatës në dokumentin përkatës. Nëse drejtimi nuk e ndryshon deklaratën, fshin referencën ndaj audituesit, ose përfshin një raport të audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura në dokumentin që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura, audituesi do të paralajmërojë drejtimin që audituesi nuk pajtohet me referencën ndaj tij, dhe do të përcaktojë dhe kryejë veprime të tjera të përshtatshme për të mos lejuar që drejtimi t'i referohet në mënyrë të papërshtatshme audituesit. (Ref: Para. A27)

\*\*\*

## **Aplikimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese**

### **Pranimi i Angazhimit (Ref: Para. 5–6)**

- A1. Auditimi i pasqyrave financiare nga të cilat rrjedhin pasqyrat financiare të përmbledhura, i jep audituesit njohuritë e nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë e tij në lidhje me pasqyrat financiare të përmbledhura në përputhje me këtë SNA. Zbatimi i këtij SNA-je nuk do të sigurojë evidencën e mjaftueshme dhe të përshtatshme mbi të cilën të bazojë opinionin mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, nëse audituesi nuk ka audituar gjithashtu pasqyrat financiare, nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura.
- A2. Fakti se drejtimi bie dakord me çështjet e përshkruara në paragrafin 6 mund të dëshmohet me anë të pranimit me shkrim të kushteve të angazhimit.

### **Kriteri(et)(Ref: Para. 6(a))**

- A3. Përgatitja e pasqyrave financiare të përmbledhura kërkon që drejtimi të përcaktojë informacionin që duhet të pasqyrohet në pasqyrat financiare të përmbledhura, në mënyrë që ato të jenë në koherencë, në të gjitha aspektet materiale, me pasqyrat financiare të audituara ose të paraqesin një përmbledhje të drejtë të këtyre të fundit. Për shkak se pasqyrat financiare të përmbledhura për nga natyra e tyre përmbajnë informacion të bashkuar dhe

informacione shpjeguese të kufizuara, ekziston një rrezik i lartë që ato të mos përmbajnë informacionin e nevojshëm në mënyrë që të mos jenë çorientuese për rrethanat. Ky rrezik rritet kur, për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura, nuk ka kritere të përcaktuara

- A4. Faktorët që mund të ndikojnë në vlerësimin nga audituesi të përshtatshmërisë së kritereve të aplikuara përfshijnë:
- Natyrën e entitetit;
  - Qëllimin e pasqyrave financiare të përmbledhura;
  - Nevojat për informacion të përdoruesve të synuar të pasqyrave financiare të përmbledhura; dhe
  - Faktin nëse kriteret e aplikuara do të rezultojnë në pasqyra financiare të përmbledhura që nuk janë çorientuese për rrethanat.
- A5. Kriteret për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura mund të vendosen nga një organizatë e autorizuar ose e njohur për hartimin e standardeve, me ligj ose rregullore. Në mënyrë të ngjashme me rastin e pasqyrave financiare, siç shpjegohet në SNA 210,<sup>13</sup> në shumë raste të tilla, audituesi mund të supozojë se këto kritere janë të pranueshme.
- A6. Kur nuk ekzistojnë kritere të përcaktuara për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura, kriteret mund të hartohen nga drejtimi, për shembull, duke u bazuar në praktikën në një sektor ekonomik të caktuar. Kriteret që janë të pranueshme në rrethanat do të rezultojnë në pasqyra financiare të përmbledhura që:
- (a) Tregojnë siç duhet natyrën e tyre të përmbledhur dhe identifikojnë pasqyrat financiare të audituara;
  - (b) Përshkruajnë qartë se nga kush ose ku vihen në dispozicion pasqyrat financiare të audituara ose, nëse ligji ose rregulli përcakton që pasqyrat financiare të audituara nuk duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve të synuar të pasqyrave financiare të përmbledhura si dhe përcakton kriteret për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura;
  - (c) Informojnë si duhet mbi kriteret e aplikuara;
  - (d) Përputhen me, ose mund të rillojariten nisur nga informacioni përkatës në pasqyrat financiare të audituara; dhe
  - (e) Në këndvështrimin e qëllimit të pasqyrave financiare të përmbledhura, përmbajnë informacionin e nevojshëm, dhe janë në një nivel të përshtatshëm të bashkimit për të mos qenë çorientuese për rrethanat.

<sup>13</sup> SNA 210, *Përcaktimi i Kushteve të Angazhimit të Auditimit*, paragrafet A3 dhe A8–A9

A7. Paraqitja e duhur e natyrës së përmbledhur të pasqyrave financiare të përmbledhura dhe identitetit të pasqyrave financiare të audituara, të përmendura në paragrafin A6 (a), mund të jepet për shembull, nëpërmjet një titulli të tillë si "Pasqyrat Financiare të Përmbledhura të Përgatitura nga Pasqyrat Financiare të Audituar për Vitin që mbyllet me datën 31 dhjetor 20X1."

#### **Vlerësimi i Disponibilitetit të Pasqyrave Financiare të Audituar**(Ref: Para. 8(g))

A8. Vlerësimi i audituesit nëse pasqyrat financiare të audituara janë të disponueshme për përdoruesit e synuar të pasqyrave financiare të përmbledhura pa vështirësi të panevojshme, ndikohet nga faktorë të tillë si fakti nëse:

- pasqyrat financiare të përmbledhura përshkruajnë qartë se nga kush ose ku janë të disponueshme pasqyrat financiare të audituara;
- pasqyrat financiare të audituara janë të përfshira në regjistër publik; ose
- drejtimi ka krijuar një proces me anë të të cilit përdoruesit e synuar të pasqyrave financiare të përmbledhura mund të kenë akses lehtësisht në pasqyrat financiare të audituara.

#### **Forma e Opinionit**(Ref: Para. 9)

A9. Një konkluzion, bazuar në një vlerësim të evidencës së marrë nga kryerja e procedurave në paragrafin 8, se është i përshtatshëm të jepet një opinion i pamodifikuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, i mundëson audituesit të shprehë një opinion që përmban një nga frazat e dhëna në paragrafin 9. Vendimi i audituesit se cilën nga frazat të përdorë mund të ndikohet nga praktika përgjithësisht e pranuar në juridiksionin në fjalë.

#### **Afatet e Punës dhe Ngjarjet pas Datës së Raportit të Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Audituar** (Ref: Para. 12)

A10. Procedurat e përshkruara në paragrafin 8 shpesh kryhen gjatë ose menjëherë pas auditimit të pasqyrave financiare. Kur audituesi raporton mbi pasqyrat financiare të përmbledhura pas përfundimit të auditimit të pasqyrave financiare, audituesit nuk i kërkohet të marrë evidencë auditimi shtesë mbi pasqyrat financiare të audituara, ose të raportojë mbi efektet e ngjarjeve që kanë ndodhur pas datës së raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara, pasi pasqyrat financiare të përmbledhura rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara dhe nuk i përditësojnë ato.

**Informacione në Dokumentet që Përmbajnë Pasqyra Financiare të Përmbledhura**  
(Ref: Para. 14–15)

- A11. SNA 720 (i rishikuar) trajton përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera në një auditim të pasqyrave financiare. Në kontekstin e SNA 720 (i rishikuar), informacioni tjetër është informacioni financiar ose jofinanciar (përveç pasqyrave financiare dhe raportit të audituesit mbi to), i përfshirë në raportin vjetor të një entiteti. Një raport vjetor përmban ose shoqëron pasqyrat financiare dhe raportin e audituesit mbi to.
- A12. Në të kundërt, paragrafët 14–15 merren me përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionin e përfshirë në një dokument që gjithashtu, përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raportin e audituesit mbi to. Ky informacion mund të përfshijë:
- Disa ose të gjitha çështjet e njëjta me ato që trajtohen në informacionin tjetër të përfshirë në raportin vjetor (p.sh., kur pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raporti i audituesit mbi to janë përfshirë në një raport vjetor përmbledhës); ose
  - Çështjet që nuk trajtohen në informacionin tjetër të përfshirë në raportin vjetor.
- A13. Gjatë leximit të informacionit të përfshirë në një dokument që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raportin e audituesit mbi to, audituesi mund të vihet në dijeni të faktit se ky informacion është çorientues dhe ai mund të ketë nevojë të ndërmarrë veprime të përshtatshme. Kërkesat përkatëse etike<sup>14</sup> kërkojnë që audituesi të shmangë lidhjen e tij, në mënyrë të vetëdijshme, me informacionin që audituesi beson se përmban një deklaratë të gabuar materiale ose çorientues, deklarata ose informacione të marra në mënyrë të pakujdesshme, ose që lënë jashtë ose fshehin informacionin që duhet të përfshihet kur kjo lënie jashtë ose fshehje do të ishte çorientuese.

*Informacionet në një Dokument që Përmban Pasqyrat Financiare të Përmbledhura që Trajton Disa ose të Gjitha Çështjet të njëjta me ato në Informacione të Tjera në Raportin Vjetor*

- A14. Kur informacioni është përfshirë në një dokument që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raportin e audituesit mbi to, dhe ky informacion trajton disa ose të gjitha çështjet që janë të njëjta me informacionin tjetër të përfshirë në raportin vjetor, puna e kryer mbi atë informacion tjetër në përputhje me SNA 720 (i rishikuar) mund të jetë e përshtatshëm për qëllimet e paragrafëve 14-15 të këtij SNA-je.
- A15. Kur në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara është

<sup>14</sup> Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël, *Kodi i Etikës për Profesionistët Kontabël* (IESBA Kodi), paragrafi 110.2

identifikuar një anomali materiale e pakorrigjuar e informacionit tjetër dhe kjo anomali materiale e pakorrigjuar lidhet me një çështje që trajtohet në informacionin e përfshirë në një dokument që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raportin e audituesit mbi to, mund të ekzistojë një mospërputhje materiale midis pasqyrave financiare të përmbledhura dhe informacionit ose informacioni mund të jetë çorientues.

*Informacionet në një Dokument që Përmban Pasqyrat Financiare të Përmbledhura që Kanë të Bëjnë me Çështje që nuk lidhen me Informacionin Tjetër në Raportin Vjetor*

A16. SNA 720 (i rishikuar), i përshtatur në mënyrën e duhur sipas rrethanave, mund të jetë i dobishëm për audituesin në përcaktimin e veprimit të duhur për t'iu përgjigjur refuzimit të drejtimit për të bërë rishikimet e nevojshme të informacionit, duke përfshirë vlerësimin e ndikimeve për raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura.

## **Raporti i Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

*Elementët e Raportit të Audituesit*

Titulli(Ref: Para. 16(a))

A17. Një titull që tregon se bëhet fjalë për raportin e një audituesi të pavarur, për shembull, "Raporti i Audituesit të Pavarur", pohon se audituesi ka përmbushur të gjitha kërkesat etike në lidhje me pavarësinë. Kjo e dallon raportin e audituesit të pavarur nga raportet e lëshuara nga të tjerët.

Marrësi (Ref: Para. 16(b), 17)

A18. Faktorët që mund të ndikojnë në vlerësimin e audituesit për përshtatshmërinë e marrësit të pasqyrave financiare të përmbledhura përfshijnë kushtet e angazhimit, natyrën e entitetit dhe qëllimin e pasqyrave financiare të përmbledhura.

Identifikimi i Pasqyrave Financiare të Përmbledhura (Ref: Para. 16(c))

A19. Kur audituesi është i vetëdijshëm se pasqyrat financiare të përmbledhura do të përfshihen në një dokument që përmban informacion tjetër përveç pasqyrave financiare të përmbledhura dhe raportit të audituesit mbi to, audituesi mund të marrë parasysh, nëse forma e prezantimit e lejon, identifikimin e numrave të faqeve në të cilat paraqiten pasqyrat financiare të përmbledhura. Kjo ndihmon që lexuesit të identifikojnë pasqyrat financiare të përmbledhura me të cilat lidhet raporti i audituesit.

Data e Raportit të Audituesit (Ref: Para. 16(m), 18)

A20. Përcaktimi i personit ose personave që kanë autoritetin të konkludojnë për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura dhe që marrin



përgjegjësinië për këto pasqyra, varet nga kushtet e angazhimit, natyra e entitetit si dhe qëllimi i pasqyrave financiare të përmbledhura.

Referenca në Raportin e Audituesit mbi Pasqyrat Financiare të Audituar (Ref: Para. 19)

- A21. Paragrafi 19 (i) i këtij SNA-je kërkon që audituesi të përfshijë një deklaratë në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, kur raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përfshin komunikimin e një ose më shumë çështjeve kryesore të auditimit të përshkruara në përputhje me SNA 701.<sup>15</sup> Megjithatë, audituesi nuk kërkohet të përshkruajë çështjet individuale kryesore të auditimit në raportin e audituesit për pasqyrat financiare të përmbledhura.
- A22. Deklarata(t) dhe përshkrimi(et) të kërkuara nga paragrafi 19 kanë për qëllim të tërheqin vëmendjen për këto çështje dhe nuk zëvendësojnë leximin e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara. Përshkrimet e kërkuara kanë për qëllim të përcjellin natyrën e çështjes(eve) dhe nuk kanë nevojë të përsërisin tekstin korrespondues të raportit të audituesit për pasqyrat financiare të audituara në tërësinë e tij.

Ilustrimet(Ref: Para. 16, 19–21)

- A23. Shtojca e këtij SNA-je përmban ilustrime të raporteve të audituesve mbi pasqyrat financiare të përmbledhura që në mënyra të ndryshme:
- (a) Përmbajnë opinione të pamodifikuara;
  - (b) Rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara mbi të cilat audituesi ka shprehur opinione të modifikuara;
  - (c) Përmbajnë një opinion të modifikuar;
  - (d) Rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara kur raporti i audituesit përfshin një deklaratë që përshkruan një anomali materiale të pakorrigjuar të informacionit tjetër në përputhje me SNA 720 (i rishikuar); dhe
  - (e) Rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara kur raporti i audituesit mbi to përfshin një seksion të *Pasigurisë Materiale në Lidhje me Vijimësinë* dhe komunikimin e çështjeve të tjera kryesore të auditimit.

**Të Dhënat Krahasuese** (Ref: Para. 23–24)

- A24. Nëse pasqyrat financiare të audituara përmbajnë të dhëna krahasuese, ekziston supozimi se pasqyrat financiare të përmbledhura gjithashtu, do të përmbajnë të dhëna të tilla krahasuese. Të dhënat krahasuese në pasqyrat financiare të audituara mund të jenë në formën e shifrave korresponduese ose

<sup>15</sup> SNA 701, paragraph 13

në formën e informacionit financiar krahasues. SNA 710 përshkruan sesi ky ndryshim ndikon në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare, duke përfshirë veçanërisht referencën për audituesit e tjerë që kanë audituar pasqyrat financiare për periudhën e mëparshme.

- A25. Rrethanat që mund të ndikojnë në vlerësimin e audituesit nëse një mungesë e të dhënave krahasuese është e arsyeshme, përfshijnë natyrën dhe objektivin e pasqyrave financiare të përmbledhura, kriteret e aplikuara dhe nevojat për informacion të përdoruesve të synuar të pasqyrave financiare të përmbledhura.

### **Informacione Plotësuese të Paaudituar të Paraqitura së bashku me Pasqyrat Financiare të Përmbledhura (Ref: Para. 25)**

- A26. SNA 700 (i rishikuar)<sup>16</sup> përmban kërkesa dhe jep udhëzime që duhet të zbatohen kur informacioni plotësues i paaudituar paraqitet së bashku me pasqyrat financiare të audituara të cilat, të përshtatura sipas nevojës për rrethanat, mund të jenë të dobishme në zbatimin e kërkesës në paragrafin 25.

### **Lidhja e Audituesit (Ref: Para. 26–27)**

- A27. Të tjera veprime të përshtatshme që audituesi mund të ndërmarrë kur drejtimi nuk ndërmerr veprimet e kërkuara, mund të përfshijnë informimin e përdoruesve të synuar dhe përdoruesve të tjerë të njohur si palë të treta, lidhur me referencën e papërshtatshme të bërë ndaj audituesit. Rrjedha e veprimit të audituesit varet nga të drejtat dhe detyrimet ligjore të audituesit. Si pasojë, audituesi mund të konsiderojë të përshtatshme që të kërkojë këshillime ligjore.

---

<sup>16</sup> SNA 700 (I Rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raporti mbi Pasqyrat Financiare*, paragrafët 53–54

**Shtojcë**

(Ref: Para. A23)

**Ilustrimet e Raporteve të Audituesit të Pavarur mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

- Ilustrimi 1: Një raport i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura të përgatitura në përputhje me kriteret e përcaktuara. Për pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion i pamodifikuar. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura daton më vonë se data e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare, nga të cilat janë nxjerrë pasqyrat financiare të përmbledhura. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përfshin një seksion të *Pasigurisë Materiale të Lidhur me Vijimësinë* dhe komunikon çështjet e tjera kryesore të auditimit.
- Ilustrimi 2: Një raport i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura të përgatitura në përputhje me kriteret e krijuara nga drejtimi dhe të komunikuar siç duhet në pasqyrat financiare të përmbledhura. Audituesi ka përcaktuar që kriteret e aplikuar janë të pranueshme për rrethanat. Për pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion i pamodifikuar. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura është i datuar në të njëjtën datë me raportin e audituesit për pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përfshin një deklaratë që përshkruan një anomali materiale të pakorrigjuar në informacionet e tjera. Informacioni tjetër me të cilin lidhet kjo anomali materiale e pakorrigjuar është gjithashtu, informacion i përfshirë në një dokument që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raportin e audituesit për to.
- Ilustrimi 3: Një raport i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura të përgatitura në përputhje me kriteret e përcaktuara nga drejtimi dhe të shpjeguara në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare të përmbledhura. Audituesi ka vlerësuar se kriteret e aplikuar janë të pranueshme për rrethanat. Për pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion me rezervë. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura është i datuar në të njëjtën datë me datën e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura.
- Ilustrimi 4: Një raport i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura të përgatitura në përputhje me kriteret e përcaktuara nga drejtimi dhe të shpjeguara në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare të përmbledhura. Audituesi ka vlerësuar se kriteret e aplikuar janë të pranueshme për rrethanat. Për pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion kundër. Raporti i audituesit për pasqyrat financiare të përmbledhura është i datuar në të njëjtën datë me datën e

raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura.

- Ilustrimi 5: Një raport i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura të përgatitura në përputhje me kriteret e përcaktuara. Për pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion i pamodifikuar. Audituesi arrin në konkluzionin se nuk është e mundur të shprehet një opinion i pamodifikuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura. Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura është i datuar në të njëjtën datë me datën e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura.

**Ilustrimi 1:****Rrethanat përfshijnë si më poshtë:**

- Për pasqyrat financiare të audituara të një entiteti të listuar është dhënë një opinion i pamodifikuar.
- Ekzistojnë kritere të përcaktuara për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura.
- Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura është i datuar më vonë se data e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura.
- Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përfshin një seksion të *Pasigurisë Materiale të Lidhur me Vijimësinë*.
- Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përfshin komunikimin e çështjeve të tjera kryesore të auditimit.<sup>17</sup>

**RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR MBI PASQYRAT FINANCIARE TË PËRMBLEDHURA**

[Marrësi i përshtatshëm]

**Opinion**

Pasqyrat financiare të përmbledhura, të cilat përfshijnë bilancin e përmbledhur të datës 31 dhjetor 20X1, pasqyrën e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e përmbledhur të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e përmbledhur të flukseve të parave për vitin e mbyllur më këtë datë, si edhe shënimet shpjeguese përkatëse, rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara të kompanisë ABC për vitin e mbyllur më datën 31 Dhjetor 20X1.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të përmbledhura bashkëngjitur janë në koherencë, (*ose janë një përmbledhje e drejtë e tyre*), në të gjitha aspektet materiale, me pasqyrat financiare të audituara, në përputhje me [përshkruani kriteret e përcaktuara].

**Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

Pasqyrat financiare të përmbledhura nuk përbajnë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara nga [përshkruani kuadrin e raportimit financiar të përdorur për përgatitjen e pasqyrave financiare të audituara të kompanisë ABC]. Prandaj, leximi i pasqyrave financiare të përmbledhura dhe i raportit të audituesit mbi to nuk zëvendëson leximin e pasqyrave financiare të audituara dhe raportin e audituesit mbi to. Pasqyrat financiare të përmbledhura dhe pasqyrat financiare të audituara nuk pasqyrojnë efektet e ngjarjeve të ndodhura pas datës së raportit tonë mbi pasqyrat financiare të audituara.

<sup>17</sup> Siç shpjegohet në paragrafin 15 të SNA 701, një pasiguri materiale lidhur me vijimësinë, është për nga natyra, një çështje kryesore e auditimit, por kërkohet të raportohet në një seksion tjetër të raportit të audituesit në përputhje me paragrafin 22 të SNA 570 (i rishikuar).

## Pasqyrat Financiare të Audituarra dhe Raporti Ynë mbi to

Në raportin tonë të datës 15 shkurt 20X2 kemi shprehur një opinion auditimi të pamodifikuar mbi pasqyrat financiare të audituara. Ky raport gjithashtu përfshin:

- Një seksion të *Pasigurisë Materiale të Lidhur me Vijimësinë*, i cili tërheq vëmendjen mbi Shënimin 6 në pasqyrat financiare të audituara. Shënimi 6 i pasqyrave financiare të audituara tregon që kompania ABC pësoi humbje neto prej ZZZ gjatë vitit që u mbyll më datën 31 dhjetor 20X1 dhe, në këtë datë, detyrimet afatshkurtra të kompanisë ABC tejkaluan totalin e aktiveve me YYY. Këto ngjarje ose kushte, së bashku me çështje të tjera të paraqitura në Shënimin 6 të pasqyrave financiare të audituara, tregojnë se ekziston një pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të mëdha në aftësinë e kompanisë ABC për të vazhduar aktivitetin në vijimësi. Këto çështje janë adresuar në Shënimin 5 të pasqyrave financiare të përmbledhura.
- Komunikimi i çështjeve të tjera<sup>18</sup> kryesore të auditimit. [Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie shumë të madhe në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale.]<sup>19</sup>

## Përgjegjësia e drejtimit<sup>20</sup> për Pasqyrat Financiare të Përmbledhura

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me [përkrahuesit kriteret e përcaktuara].

## Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të japim një opinion mbi faktin nëse pasqyrat financiare të përmbledhura janë në të gjitha aspektet materiale, në koherencë (ose janë një përmbledhje e drejtë e tyre) me pasqyrat financiare të audituara bazuar në procedurat tona, të cilat janë kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 810 (i rishikuar), *Angazhimet për Raportimin e Pasqyrave Financiare të Përmbledhura*.

[Firma e audituesit]

[Adresa e audituesit]

[Data e raportit të audituesit]

<sup>18</sup> Në rrethanat kur nuk ka pasiguri materiale lidhur me vijimësinë, përfshirja e fjalës "tjetër" në një deklaratë për komunikimin e çështjeve kryesore të auditimit nuk është e nevojshme.

<sup>19</sup> Audituesi mund të përfshijë shpjegime shtesë mbi çështjet kryesore të auditimit, që konsiderohen të dobishme për përdoruesit e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura.

<sup>20</sup> Ose një term tjetër që është i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin përkatës.

**Ilustrimi 2:****Rrethanat përfshijnë si më poshtë:**

- Për pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion i pamodifikuar
- Kriteret janë hartuar nga drejtimi dhe ato janë shpjeguar në mënyrë të përshtatshme në Shënimin X. Audituesi ka vlerësuar se kriteret janë të pranueshme për rrethanat.
- Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura ka të njëjtën datë me datën e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura.
- Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara përfshin një deklaratë që përshkruan një anomali materiale të pakorrigjuar të informacionit tjetër. Informacioni tjetër me të cilin lidhet kjo anomali materiale e pakorrigjuar është gjithashtu, informacion i përfshirë në një dokument që përmban pasqyrat financiare të përmbledhura dhe raportin e audituesit mbi to.

**RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR MBI PASQYRAT FINANCIARE TË PËRMBLEDHURA**

[Marrësi i përshtatshëm]

**Opinionit**

Pasqyrat financiare të përmbledhura, të cilat përfshijnë bilancin e përmbledhur më datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e përmbledhur të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e përmbledhur të flukseve të parave për vitin e mbyllur me këtë datë, si dhe shënimet përkatëse, rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara të kompanisë ABC për vitin që është mbyllur më datën 31 Dhjetor 20X1.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të përmbledhura bashkëngjitur janë në koherencë (ose janë një përmbledhje e drejtë e tyre), në të gjitha aspektet materiale, me pasqyrat financiare të audituara, mbi bazën e përshkruar në Shënimin X.

**Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

Pasqyrat financiare të përmbledhura nuk përbajnë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara nga [përshkruani kuadrin e raportimit financiar të përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare të audituara të kompanisë ABC]. Prandaj, leximi i pasqyrave financiare të përmbledhura dhe raportit të audituesit mbi, to nuk zëvendëson leximin e pasqyrave financiare të audituara dhe raportin e audituesit mbi to.

**Pasqyrat Financiare të Audituar dhe Raporti Ynë mbi to**

Në raportin tonë të datës 15 shkurt 20X2 ne kemi shprehur një opinion auditimi të pamodifikuar mbi pasqyrat financiare të audituara. [Pasqyrat financiare të audituara janë përfshirë në Raportin Vjetor 20X1. Raporti i audituesit për pasqyrat financiare të audituara përfshin një deklaratë që përshkruan një anomali materiale të pakorrigjuar të informacioneve të tjera në Diskutimin dhe Analizën e Drejtimit të përfshirë në Raportin Vjetor 20X1. Diskutimi dhe Analiza e Drejtimit, dhe anomalia materiale e pakorrigjuar e informacionit tjetër në të, janë gjithashtu të përfshira në Raportin Vjetor të Përmbledhur 20X1.] [*Përshkruaj anomalinë materiale të pakorrigjuar të informacionit tjetër*].

### **Përgjegjësia e Drejtimit<sup>21</sup> për Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura mbi bazën e përshkruar në shënimin X.

### **Përgjegjësia e audituesit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi faktin nëse pasqyrat financiare të përmbledhura janë, në të gjitha aspektet materiale, në koherencë, (*ose japin një përmbledhje të drejtë të tyre*) me pasqyrat financiare të audituara bazuar në procedurat tona, të cilat janë kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 810 (i rishikuar), *Angazhimet për Raportimin e Pasqyrave Financiare të Përmbledhura*.

[Firma e audituesit]

[Adresa e audituesit]

[Data e raportit të audituesit]

---

<sup>21</sup> Ose një term tjetër i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin përkatës



**Ilustrimi 3:**

**Rrethanat përfshijnë si më poshtë:**

- **Për pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion me rezervë.**
- **Kriteret janë hartuar nga drejtimi dhe janë shpjeguar në mënyrë të përshtatshme në Shënimin X. Audituesi ka vlerësuar se kriteret janë të pranueshme për rrethanat.**
- **Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura mban të njëjtën datë me datën e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura.**

**RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR MBI PASQYRAT FINANCIARE TË PËRMBLEDHURA**

[Marrësi i përshtatshëm]

**Opinion**

Pasqyrat financiare të përmbledhura, të cilat përfshijnë pasqyrën e përmbledhur të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 20X1, pasqyrën e përmbledhur të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e përmbledhur të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e përmbledhur të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe shënimet përkatëse, kanë rrjedhur nga pasqyrat financiare të audituara të kompanisë ABC (Kompania) për vitin që mbyllet më datën 31 Dhjetor 20X1. Ne kemi shprehur një opinion auditimi me rezerve për këto pasqyra financiare në raportin tonë të datës 15 shkurt 20X2.<sup>22</sup>

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të përmbledhura bashkëngjitur janë, në të gjitha aspektet materiale, në koherencë, *(ose janë një përmbledhje e drejtë e tyre)*, me pasqyrat financiare të audituara mbi bazën e përshkruar në Shënimin X. Megjithatë, pasqyrat financiare të përmbledhura përmbajnë anomali materiale në të njëjtën masë si edhe pasqyrat financiare të audituara të kompanisë ABC për vitin e mbyllur më datën 31 dhjetor 20X1.

**Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

Pasqyrat financiare të përmbledhura nuk përmbajnë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara nga [përshkruani kuadrin e raportimit financiar të përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare të audituara të kompanisë ABC]. Prandaj, leximi i pasqyrave financiare të përmbledhura dhe i raportit të audituesit mbi to nuk zëvendëson leximin e pasqyrave financiare të audituara dhe të raportit të audituesit mbi to.

<sup>22</sup> Pozicionimi i kësaj reference në opinionin me rezervë në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të audituara në paragrafin e Opinioneve mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, ndihmon përdoruesit të kuptojnë se, megjithëse audituesi ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura, këto të fundit pasqyrojnë pasqyrat financiare të audituara të keqparaqitura materialisht .

### **Pasqyrat Financiare të Audituarra dhe Raporti Ynë mbi to**

Ne kemi shprehur një opinion auditimi me rezervë mbi pasqyrat financiare të audituarra në raportin tonë të datës 15 shkurt 20X2. Baza e opinionit tonë të auditimit me rezervë ishte [fakti që drejtimi nuk i ka paraqitur inventarët me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme, por i ka paraqitur ato vetëm me koston, që përbën një devijim nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar]. Regjistrimet e Kompanisë tregojnë se nëse drejtimi do të kishte paraqitur inventarët me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme, do të duhej që inventarët të uleshin në vlerë në shumën prej xxx të vlerës së tyre neto të realizueshme. Për rrjedhojë, kosto e shitjeve do të rritej me shumën prej xxx, dhe tatimi mbi të ardhurat, të ardhurat neto dhe kapitali i aksionerëve do të ishte ulur respektivisht në shumat xxx, xxx dhe xxx.

### **Përgjegjësia e drejtimit<sup>23</sup> për Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura mbi bazën e përshkruar në shënimin X.

### **Përgjegjësia e audituesit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi faktin nëse pasqyrat financiare të përmbledhura janë, në të gjitha aspektet materiale, në koherencë (*ose janë një përmbledhje e drejtë e tyre*) me pasqyrat financiare të audituarra bazuar në procedurat tona, të cilat janë kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 810 (i rishikuar), *Angazhimet për Raportimin e Pasqyrave Financiare të Përmbledhura*.

[Firma e audituesit]

[Adresa e audituesit]

[Data e raportit të audituesit]

---

<sup>23</sup> Ose një term tjetër i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin përkatës.

**Ilustrimi 4:****Rrethanat përfshijnë si më poshtë:**

- Për pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion kundër.
- Kriteret janë hartuar nga drejtimi dhe janë shpjeguar në mënyrë të përshtatshme në Shënimin X. Audituesi ka vlerësuar se kriteret janë të pranueshme për rrethanat.
- Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura mban të njëjtën datë me datën e raportit të audituesit për pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura.

**RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR MBI PASQYRAT FINANCIARE TË PËRMBLEDHURA**

[Marrësi i përshtatshëm]

**Refuzimi i Dhënies së Opinioneve**

Pasqyrat financiare të përmbledhura, të cilat përfshijnë bilancin përmbledhës të datës 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e përmbledhur të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e përmbledhur të flukseve të parave për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe shënimet shpjeguese përkatëse, rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara të kompanisë ABC për vitin që është mbyllur më datën 31 Dhjetor 20X1.

Si rezultat i opinionit kundër mbi pasqyrat financiare të audituara të diskutuara në seksionin e raportit tonë për *Pasqyrat Financiare të Audituar dhe Raportin tonë mbi këto pasqyra*, është e papërshtatshme të jepet një opinion mbi pasqyrat financiare të përmbledhura.

**Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

Pasqyrat financiare të përmbledhura nuk përmbajnë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara nga [përkrahuesi i kuadrin e raportimit financiar të aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të audituara të kompanisë ABC]. Prandaj, leximi i pasqyrave financiare të përmbledhura dhe e raportit të audituesit nuk zëvendëson leximin e pasqyrave financiare të audituara dhe raportin e audituesit për këto pasqyra.

**Pasqyrat Financiare të Audituar dhe Raporti Ynë mbi to**

Në raportin tonë të datës 15 shkurt 20X2, ne kemi shprehur një opinion kundër mbi pasqyrat financiare të audituara të kompanisë ABC për vitin që u mbyll më datën 31 Dhjetor 20X1. Baza për opinionin tonë kundër ishte [përkrahuesi i bazën për opinionin e auditimit kundër].

### **Përgjegjësia e drejtimit<sup>24</sup> për Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare mbi bazën e përshkruar në shënimin X.

### **Përgjegjësia e audituesit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për faktin nëse pasqyrat financiare të përmbledhura janë në koherencë, në të gjitha aspektet materiale, *(ose janë një përmbledhje e drejtë e tyre)* me pasqyrat financiare të audituara, bazuar në procedurat tona, të cilat janë kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 810 (i rishikuar), *Angazhimet për Raportimin e Pasqyrave Financiare të Përmbledhura*.

[Firma e audituesit]

[Adresa e audituesit]

[Data e raportit të audituesit]

---

<sup>24</sup> Ose nje term tjetër i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin përkatës

**Ilustrimi 5:**

**Rrethanat përfshijnë si më poshtë:**

- **Për pasqyrat financiare të audituara është dhënë një opinion i pamodifikuar.**
- **Ekzistojnë kritere të përcaktuara për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura.**
- **Audituesi arrin në konkluzionin se nuk është e mundur të jepet një opinion i pa modifikuar mbi pasqyrat financiare të përmbledhura.**
- **Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare të përmbledhura mban të njëjtën datë me datën e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare nga të cilat kanë rrjedhur pasqyrat financiare të përmbledhura.**

**RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR MBI PASQYRAT FINANCIARE TË PËRMBLEDHURA**

[Marrësi i përshtatshëm]

**Opinionit Kundër**

Pasqyrat financiare të përmbledhura, të cilat përfshijnë bilancin përmbledhës të datës 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e përmbledhur të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e përmbledhur të flukseve të parave për vitin e mbyllur me këtë datë, si dhe shënimet përkatëse, rrjedhin nga pasqyrat financiare të audituara të kompanisë ABC për vitin që ka përfunduar më datën 31 Dhjetor 20X1.

Sipas opinionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes së përshkruar në seksionin *Bazat për Opinionit Kundër*, pasqyrat financiare të përmbledhura bashkëlidhur, nuk janë në koherencë (*ose nuk japin një përmbledhje të drejtë të tyre*) me pasqyrat financiare të audituara të kompanisë ABC për vitin e mbyllur më datën 31 dhjetor, 20X1, në përputhje me [përshkruani kriteret e përcaktuara].

**Baza për Opinionin Kundër**

[Përshkruani çështjen që ka bërë që pasqyrat financiare të përmbledhura, të mos jenë, në të gjitha aspektet materiale, në koherencë, (*ose që nuk japin një përmbledhje të drejtë të tyre*), me pasqyrat financiare të audituara në përputhje me kriteret e aplikuar].

**Pasqyrat Financiare të Përmbledhura**

Pasqyrat financiare të përmbledhura nuk përmbajnë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara nga [përshkruani kuadrin e raportimit financiar të përdorur për përgatitjen e pasqyrave financiare të audituara të kompanisë ABC]. Prandaj, leximi i pasqyrave financiare të përmbledhura dhe raportit të audituesit mbi këto pasqyra, nuk zëvendëson leximin e pasqyrave financiare të audituara dhe raportit të audituesit mbi to.



## **Pasqyrat Financiare të Audituarra dhe Raporti Ynë mbi to**

Në raportin tonë të datës 15 shkurt 20X2 kemi shprehur një opinion auditimi të pamodifikuar mbi pasqyrat financiare të audituarra.

## **Përgjegjësia e Drejtimit<sup>25</sup> për Pasqyrat Financiare të Përmbledhura të Audituarra**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të përmbledhura në përputhje me [përshkruani kriteret e përcaktuara].

## **Përgjegjësia e audituesit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për faktin nëse pasqyrat financiare të përmbledhura janë, në të gjitha aspektet materiale, në koherencë (*ose janë një përmbledhje e drejtë e tyre*), me pasqyrat financiare të audituarra, bazuar në procedurat tona, të cilat janë kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 810 (i rishikuar), *Angazhimet për Raportimin e Pasqyrave Financiare të Përmbledhura*.

[Firma e audituesit]

[Adresa e audituesit]

[Data e raportit të audituesit]

---

<sup>25</sup> Ose një term tjetër i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin përkatës